



20.12.2006

## Informata themelore - E drejta e punes Aufenthaltsgestattung / Duldung Basisinformation - Arbeitserlaubnis albanisch

Me nje **Duldung** apo lejeqendrim e keni **Aufenthaltsgestattung** nje „casje me te ulet ne tregun e punes“, Puna e pavarur s'lejohtet. E drejta e punes **Arbeitserlaubnis** quhet ne menyre korrekte „Leja per t'u marr me nje pune“ - **Erlaubnis zur Ausübung einer Beschäftigung**. Puna eshte nje veprim ne nje marredhenie pune sipas urdherave te punedheneseve dhe si pjese e nje organizimi punesues (§ 7 SGB IV).

- Per praktika dhe kohe sprovuese qe s'paguhen nevojitet rregullisht nje leje pune.
- Punet-per 1 Euro (te njohur si **1-Euro-Jobs**) behen me ndermjetesimin e autoriteteve zyrtare dhe s'kane nevoje per leje pune.
- Me e komplikuar eshte pjesa per punet vullnetare pa pagese. Nese po e njejta pune rendom paguhet, do te mund te ishte nje lejepune e nevojshme .

### Leja e punes Arbeitserlaubnis

Pas nje vit lejeqendrimi **Aufenthaltsgestattung** apo **Duldung** mund ta merrni lejen e punes. Se pari duhet ta gjeni nje vend te punes dhe punedhenesi/sja duhet personalisht t'ju ofroje vendin e punes. Tek autoritetet zyrtare per te Huajte e **Ausländerbehörde** parashtroni kerkesen „Leja per t'u marr me nje pune“, por cdokund nuk mund te gjenden formulare per kete gje. Autoritetet zyrtare per te Huajte **Ausländerbehörde** verifikojne, se a kane verejtje apo pengesa lidhur me te drejten e qendrimin. Nese ky verifikim merr pergjigje te mire, kerkesa juaj dergohet metutje tek Enti per Punesim (e njohur si **Arbeitsagentur**).

- Ju e parashtroni kerkesen tek autoritetet zyrtare per te Huajte **Ausländerbehörde**. Ajo eshte kompetente per pranimin / mospranimin perfundimtar. Autoritetet zyrtare per te Huajte **Ausländerbehörde** e marrin mendimin e entit per punesim ne menyre interne.
- Nje lejepune leshohet vetem per nje vend pune te caktuar dhe eshte me kohe te caktuar (Kerkesa per vazhdim duhet te behet me kohe).
- Shefi / Shefja duhet te beje shenime te sakta per vendin dhe kushtet e punes dhe duhet te pajtohet me ate, qe ky vend pune te ofertohet publikisht nga enti per punesim. Me mire do te ishte: qe entit per punesim **Arbeitsagentur** t'i jete ofertuar me heret ky vend pune.
- Pagesa e ores se punes duhet te jete njejte si ne rrethine, kushtet dhe orari i punes lejohen te jene te pazakonshme, por s'ben te jene jashte normave morale e edukative.
- Me nje leje qendrim apo **Duldung** s'keni te drejte juridike per nje lejepune. Leshimi i saj varet nga autoritetet zyrtare per te Huajte **Ausländerbehörde**.

### Ndalim punesimi Arbeitsverbot

Me nje lejeqendrim **Aufenthaltsgestattung** pas nje viti s'eshte i mundshem ndalimpunesimi paushal nga autoritetet zyrtare per te Huajte **Ausländerbehörde**. Personave me **Duldung** mund t'ju ndalohtet nisja e punes nga ana e autoriteteve zyrtare per te Huajte.

- Kur ta parashtroni kerkesen, autoritetet zyrtare per te Huajte e verifikojne **Ausländerbehörde**, se a i plotesoni kriteret „e te drejtes se qendrimin“ per leje pune. Kesaj i takojne pritja e caktuar kohore prej 1 viti, gatishmeria juaj per bashkepunim me autoritetet gjermane dhe pyetja, se a ju bejne autoritetet zyrtare per te Huajte juve fajtor, qe kthimi juaj eshte i pamundshem.

- "Te huajve me **Duldung** s'ben t'u lejohet marrja me pune, nese ... per arsye te varura nga ata, s'mund te aplikohen ndaj tyre masat per ndalim te qendrimit. Nje i huaj duhet te pranoje pergjegjesine e ketyre arsytiveve posaqerisht atehere, nese ka ndikuar ne pengimin e kthimit, duke mashtruar lidhur me identitetin apo kur ka dhene shenime te gabuara lidhur me nenshtetesine apo per shenime tjera..." (citati: § 11 BeschVerfVO)
- Marrja me pune ndalohet edhe atehere, kur autoritetet zyrtare e kane dyshimin, se dikush ka ardhur ne Gjermani vetem per te marr sherbimet e beneficinet e azilkerkimit.

## Verifikimi i tregut te punes

### Arbeitsmarktprüfung

Ne Gjermani numri i papunesise eshte shume i larte. Per kete arsye eshte zbuluar "verifikimi per perparesi". Njerezve me nje titull te sigurte qendrimi (gjermaneve, shtetasve te Bashkesise Evropiane, njerezve me leje e te drejte qendrimi **Aufenthalts-**

**berechtigung**) ju ofrohet se pari nje vend pune. Enti per punesim **Arbeitsagentur** l fton punedhenesit/set potenciale, qe te paraqesin nje kerkese per ndermjetesim ne punesim e mepas l dergon "te papunet me privilegje" ne interviste. Nese keta te njejtet e refuzojne nje vend pune, atehere ndaj tyre ka sanksione. Poashtu shikohet puna e pageses, orari i punes etj, pasiqe kushtet e punes per persona me **Duldung** s'ben te jete me e keqe sesa e tjereve. Punedhenesi / sja duhet te japin informata lidhur me kete. Verifikimi i tregut te punes ne menyren me por ai mund te zgjase edhe deri ne 6 muaj. Mund te ngreni padi pas 3 muajsh. Nese krejt keto parakushte jane permbushur dhe shefi / shefja s'ka gjetur kend tjeter, qe eshte i afte per ate vend pune, shefi / shefja per kete gje duhet t'i arsyetohet detajisht Entit per Punesim. Pas asaj mund ta jep pelqimin e pajtimit per leje pune.

- Disa Ente per Punesim **Arbeitsagentur** thojne,

qe te gjitha vendet e punes me max. 400 € dheato me orar te plote, ku s'kerkohet ndonje shkolle profesionale

e kryer, parimisht duhet te mirren e te zihen nga te papunet e privilegjuar. Per kete arsye kerkesat e tilla paushal refuzohen. Kerkoni perhere nje verifikim te vecante te rastit.

- Punedhenesi / sja do te duhej ta pershkruante detajisht, se perse ju jeni me i pershtatshem per kete pune, sesa kandidatet tjere (p.sh. njohurite e gjuheve te huaja, eksperiencia etj).
- Ne raste te renda e drejta per verifikim te tregut te punes bie poshte, p.sh. pas deshmise se mjekut, se ai vend pune eshte shume i rendesishem per sherimin e nje semundjeje – hulumtoni, se a keni ne rastin tuaj nje „rast te rende“. Gjate paraqitjes se kerkeses i cekni direkt edhe te gjitha arsytet tuaja te posaqme.

## Ankesa, Padi dhe Shpenzimet

### Widerspruch, Klage und Kosten

Paraqitja e kerkeses eshte gratis e s'kushton asgje. Nese kerkesa juaj refuzohet mund te paraqitni ankesen tuaj brenda nje muaji ne menyre te shkruar apo gojore. Arsyetimin mund ta dorezoni pas nje kohe shume te shkurter.

- Per ankese ju duhet nje shkrese juridike e shkruar nga autoritetet zyrtare per te Huajte

**Ausländerbehörde**. Ky ent eshte i detyruar, qe kete ta leshoje pa pagese. Ankesa duhet te shqyrtohet e te perpunohet nga nje person tjeter ne Entin per Huajte **Arbeitsagentur**.

- Nese ankesa ju refuzohet, e keni te drejten, qe t'kerkoni qe t'ju kthehet pagesa e perpunimit te lendes, pasiqe merrni te holla si azilkerkues. Krejt kjo eshte, sepse pergjegjja e kundershtimit ju kthehet me leter rekomande, ku disa Ente per te Huajte **Arbeitsagentur** mu per kete kerkojne shpenzime nga ju (perafersisht 4€).

- Si hap tjeter ne radhe mund te paraqitni padi kunder Entit per te Huajte ne gjyq. Ne ju keshillojme, qe njekohesisht ta paraqitni nje kerkese emergjente (te arsyetuar mire) ne gjyq, ku kerkoni, qe gjyqi ta detyroje Entin per te Huajte **Arbeitsagentur**, qe (perkohesisht) t'ju leshoje nje leje pune gjersa te perfundon procesi gjyqesor.

- Per nje padi ju nevojitet nje avokat / avokate, qe e njeh mire kete lemi. Per konsulencen e tij te pare per juve, avokati mund te paraqese kerkese per ndihme keshilluese. Kur ka gjasa, se mund ta fitoni e te keni sukses ne kete lende tuajen, atehere mund te kerkoni ne gjyq ndihme per shpenzimet e procesit gjyqesor. Edhe ne rast se e humbni procesin gjyqesor, atehere ju s'do te keni nevojte te paguani gje.

## Puna ilegale

### Illegale Arbeit

Nese ju punoni pa e pasur nje leje pune per ate vend ku punoni, atehere kjo eshte pune ilegale. Nga ana juridike kjo pune e ashtuquajtur „pune ne te zezen“ **illegale Arbeit** sjell me vete denim per juve dhe punedhenesin / sen tuaj. Rrezikoni te paguani shuma te larta si denim dhe te ju bejne procese penale. Kjo

mund te kete ndikim negativ ne lenden tuaj per marrjen e nje leje qendrimi te qendrueshme (p.sh. nese keni gjasa per leje qendrim) dhe mund ta rrise presionin e detyrimit te kthimit kunder jush.

• Mendoni mire, se kur mirreni me pune ilegale, atehere lehte mund te ju shantazhojne. Shume shpesh punetoret, qe punojne ilegalisht nuk paguhen apo paguhen shume dobte nga punedhenesit/set e tyre dhe eshte shume veshtire, qe te beni dicka kunder tyre, ne rast se s'ju paguajne fare.

---

Ju lutem vini rei: Keto informata jane mbledhur e pergatitur mire sipas njohurive te sakta, mirepo keto nuk e zevendesojne konsulencen juridike. Te gjitha te dhenat bazohen ne gjendjen e dhjetorit 2006, Schleswig-Holstein.

Bitte beachten Sie: Diese Informationen sind nach bestem Wissen erstellt. Sie ersetzen keine juristische Beratung. Alle Angaben beziehen sich auf Schleswig-Holstein. 12/2006

Projekti *INFONET* - Bildungs- und Berufszugänge für Flüchtlinge (casje e azilkerkuesve per shkollim e profesione) ben pjese ne grupo Land in Sicht! - Berufliche Qualifizierung für Flüchtlinge in Schleswig-Holstein (partneriteti zhvillimor Vendi ne Horizont! - Kualifikimi profesional per azilkerkuesit, qe mbahet e perkrahet nga Flüchtlingsrat Schleswig-Holstein (Keshilli i azilkerkuesve Schleswig-Holstein).

Das Projekt *INFONET* - Bildungs- und Berufszugänge für Flüchtlinge gehört zu der Gruppe Land in Sicht! - Berufliche Qualifizierung für Flüchtlinge in Schleswig-Holstein und wird vom Flüchtlingsrat Schleswig-Holstein getragen.

Flüchtlingsrat ekziston nga viti 1991 dhe eshte permbledhje kulmore e iniciativave, grupeve, organizatave dhe personave te caktuar per ndihmese solidare per te ikurit (azilkerkuesit) ne Flüchtlingshilfe in Schleswig-Holstein. Kjo mirret me pune publike antirasiste dhe perfaqeson brenga te azilit dhe te politikës se migracionit karshi entve dhe autoriteteve zyrtare te krahines. Kjo OJQ eshte pjesemarres ne shoqaten punuese PRO ASYL, qe vepron ne tere Gjermanine.

Der Flüchtlingsrat besteht seit 1991 und ist Dachverband von Initiativen, Gruppen, Organisationen und einzelnen Personen der solidarischen Flüchtlingshilfe in Schleswig-Holstein.

Er leistet antirassistische Öffentlichkeitsarbeit und vertritt flüchtlings- und migrationspolitische Anliegen gegenüber Behörden und Landesregierung. Der Verein ist Mitglied in der bundesweiten Organisation für Flüchtlinge PRO ASYL.

## **INFONET**

*Bildungs- und Berufszugänge für Flüchtlinge*  
**Flüchtlingsrat Schleswig-Holstein e.V.**

Oldenburger Str. 25  
24143 Kiel

Tel. 0431 - 240 59 09  
oder 0431 - 735 000

infonet@frsh.de

**www.infonet-frsh.de**



*INFONET* wird gefördert durch  
das Bundesministerium für Arbeit und Soziales, den Europäischen Sozialfonds, das Land Schleswig-Holstein und PRO ASYL



Bundesministerium  
für Arbeit und Soziales



**PRO ASYL**  
Förderverein PRO ASYL e.V.

Flüchtlingsrat  
Schleswig-Holstein e.V.

